# KESHILLI I BASHKISE
# K O R Ç E

---

# VENDIM

**Nr 7 Date 21.03, 2007**

## PER NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE ADMINISTRIMIN E TYRE

Keshilli I Bashkise Korce ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi morri ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e te Ardhurave, bazuar ne ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" neni 35 dhe ne ligjin nr. 8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"

## VENDOSI :

I. Te miratoje nivelet e meposhteme te tarifave dhe taksave vendore.

| I. | LLOJI I TARIFES | VLERA |
|---|---|---|
| 1. | TARIFE PER RREGJISTRIM VEPRIMTARIE<br>- per persona fizike qe bejne tregeti dhe kryejne<br>- sherbime ambulante<br>- per persona fizike e juridike shteterore e private vendas e te huaj | <br><br>2500 leke ne vit<br><br>20000 leke ne vit |
| 2. | TARIFE PER PASTRIM<br>- çdo familje<br>- çdo njesi tregetimi per bulmet, mish, peshk<br>- cdo njesi tregtimi per fruta- perime<br>- cdo njesi tregtimi ushqimore<br>- çdo njesi tregetimi per artikuj industriale<br>- per restorante, bar bufe, diskoteka, lojra fati, etj.<br>- Per hotele, motele, komplekse turistike<br>- per konvikte, pensione, shtepi pushimi, spitale, martenitete<br>• shteterore<br>• private<br>- per mjedise administrative (zyra, salla mbledhjesh)<br>• shteterore<br>• private<br>- per institucione social – kulturore<br>- per institucione sportive ekspozita, panaire<br>- per cdo njesi sherbimi dhe artizanati B.V<br>- farmaci, klinika<br>- per cdo njesi prodhimi<br>- subjekte b.vogel qe tregetojne ne tregun e lire te qytetit ne prona publike | <br>600 leke ne vit<br>15000 leke ne vit<br>20000 leke ne vit<br>10000 leke ne vit<br>7500 leke ne vit<br>15000 leke ne vit<br>20000 leke ne vit<br><br>30 leke vit / dhome<br>750 leke vit / dhome<br><br><br>100 leke vit / dhome<br>750 leke vit / dhome<br>10000 leke vit / njesi<br>20000 leke vit / njesi<br>5000 leke vit / njesi<br>20000 leke vit / njesi<br>15000 leke vit<br><br>1500 leke vit |

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP www.infocip.org

| | | |
|---|---|---|
| | - te gjithe personat qe klasifikohen si ambulante<br>- per çdo njesi supermarketi<br>- per çdo njesi ndertimi<br><br>KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET ME T.V.SH<br>- per cdo subjekt ndertimi<br>- per njesi tregtimi, sherbimi e artizanati<br>- per cdo njesi prodhimi<br>- per cdo njesi hoteli, moteli, pike turistike | 1500 leke vit<br>50000 leke vit<br>25000 leke vit<br><br><br>60000 leke / vit<br>20000 leke / vit<br>50000 leke / vit<br>50000 leke / vit |
| 3. | TARIFE REKLAME<br>- e thjeshte<br>- elektronike | <br>10000 leke vit/$m^2$<br>20000 leke vit/$m^2$ |
| 4. | TARIFE PER RREGJISTRIM VENDBANIMI | 1000 leke |
| 5. | TARIFE PARKIMI PER AUTOMJETE<br>- taksi 8 + 1<br>- taksi 4 + 1<br>- autobuse<br>- autovetura<br>- automjet transport malli deri 3,5 T(me ngarkese)<br>- automjet transport malli mbi 3,5 T (me ngarkese)<br>- motomjet transport malli (motokarro) | <br>8000 leke / vit<br>4000 leke / vit<br>15000 leke / vit 50 lek /ore<br>1500 leke /vit 10 lek/ore<br>2000 leke / vit 20 lek/ore<br>1500 leke / vit<br>1500 leke /vit 10 lek/ore |
| 6. | TARIFE PER THERJEN E BAGETIVE<br>a – tarife per therje ne thertoren e Bashkise<br>- Gjedhe<br>- Te imta<br>- Derra<br><br>b – tarife per certifikimin ne thertoren private<br>- Gjedhe<br>- Te imta<br>- Derra<br><br>c – tarife per certifikimin e mallrave per import – export<br>- certifikate vertetim per export<br>- certifikate vertetim per import<br>- certifikate vertetim per kafshe luksi<br>- kafshe dhe shpende gjahu<br><br>d - tarife per certifikate per mallra qe qarkullojne brenda vendit. ( Produkte ushqimore me origjine shtazore ) | <br><br>500 leke<br>200 leke<br>300 leke<br><br><br>200 leke<br>100 leke<br>150 leke<br><br><br>3000 leke<br>5000 leke<br>1000 leke<br>1000 leke<br><br>1000 leke |
| 7. | TARIFE PER TAVOLINA JASHTE LOKALEVE | 50 leke/dite per cdo tavoline |
| 8. | TARIFE PER $M^2$ MUR TE JASHTEM PER CDO NDERTESE TE RE | 20 leke |

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP www.infocip.org

| | | |
|---|---|---|
| 9. | TARIFE PER SERVITUTIN E KALIMIT NE PRONAT PUBLIKE<br>- per zonen qender qyteti dhe bulevardet kryesore<br>• rruge kalimi<br>• hapesirat e tjera<br><br>- per zonat e tjera te qytetit<br>• rruge kalimi<br>• hapesirat e tjera | <br><br>180 lek/m$^2$ ne muaj<br>250 lek/m$^2$ ne muaj<br><br><br>150 lek/m$^2$ ne muaj<br>200 lek/m$^2$ ne muaj |
| 10. | TARIFE GJELBERIMI<br>- çdo familje<br>- çdo njesi e klasifikuar pa TVSH<br>- çdo njesi e klasifikuar me TVSH | <br>100 leke ne vit<br>1000 leke ne vit<br>2000 leke ne vit |
| 11. | TARIFE PLAN – VENDOSJE (GENT-PLANIT) | 3000 lek |
| 12 | TARIFE PER PERDORIM TE TREGUT TE LIRE TE QYTETIT<br>a) Per tregetim mallra industriale<br>b) Per tregetim mallra ushqimore, fruta-perime, veze<br>c) Per tregetim mish, peshk, bulmet | <br>30 lek/m2/dite.<br>40 lek/m2/dite<br><br>50 lek/m2/dite |
| 13 | TARIFE PER EKSPOZIM MALLI JASHTE DYQANIT | 30 lek/m2/ dite |
| 14 | TARIFE DHENIE LEJE<br>kantina<br>- zona A<br>- zona B<br>kende lojnash | <br><br>60 lek/m2/dite<br>40 lek/m2/ dite<br>40lek/m2/dite. |
| 15 | TARIFE NDRIÇIMI<br>- çdo familje<br>- çdo njesi e klasifikuar pa TVSH<br>- çdo njesi e klasifikuar me TVSH | <br>200leke ne vit<br>2000leke ne vit<br>5000leke ne vit |
| II | LLOJI I TAKSES | |
| 1. | TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIME TE REJA<br>Baza e llogaritjes si ajo e vendosur me V.K.B | <br>1% e vleres se investimit<br>1% studime urbanistike |
| 2. | TAKSA E TABELES<br>- ne shqip<br>- ne gjuhe te huaj | <br>500<br>5000 |
| 3. | TAKSE MBI NDERTESAT E BANIMIT (Shtepite e banimit) | 8.4 lek/m$^2$ |

II. Mbeten ne fuqi te gjitha taksat dhe tarifat e tjera qe jane miratuar me Ligj ose me V.K.B. dhe qe nuk jane permendur ne kete material.

III. Subjektet e biznesit te madh paguajne detyrimet per njesine qendrore si te tille dhe si ato te biznesit te vogel per cdo njesi tjeter te tyre sipas llojit te aktivitetit qe kryejne.

IV. Perjashtohen nga pagesa te gjitha rastet e parashikuara me Ligj.

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org

V. Pagesa e taksave vjetore, kur detyrimi i pageses lind 6/mujorin e pare do te behet e plote dhe kur lind 6/mujorin e dyte do te jete ½ e vleres se takses dhe tarifes.

VI. Mbledhja e tyre do te behet nga vete strukturat e Bashkise.

VII. Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohen te gjitha Drejtorite ne Bashki e vecanerisht Drejtoria e te Ardhurave.

VIII. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

**RAJMONDA NASE**

Rajmonda Nase

**KRYETAR**

Dixhitalizuar nga Qendra CIP
www.infocip.org

# BASHKIA KORCE
# DREJTORIA E TE ARDHURAVE

---

## R E L A C I O N

### *PER MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE*

Ne baze te ligjit Nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", neni 35, ligjit nr 8562 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 8 "Te drejtat e njesise se qeverisjes vendore", pika II "E drejta e mbjedhjes se te ardhurave dhe berjes se shpenzimeve", germa b e cila parashikon te drejten e "vendosin taksa e tarifa per sherbimet si dhe nivelin e tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe interesat e bashkise", nenin 16 "Te ardhurat e veta te komunes dhe Bashkise", pika 2 e cila parashikon "...komuna dhe bashkia kane te drejte te zbatojne ose jo nje takse ose tatim vendor te percaktuar", neni 32 "Detyrat dhe kompetencat e keshillit komunal ose bashkiak", germa f e cila parashikon te drejten e "vendos per taksat dhe tarifat vendore si dhe nivelin e tyre", paraqesim per miratim ne keshillin bashkiak relacionin mbi miratimin e nivelit te taksave dhe tarifave vendore duke specifikuar:

Meqenese buxheti i Bashkise Korce eshte miratuar ne Keshillin e Bashkise, pergjithesisht niveli i taksave dhe tarifave vendore, nuk do te ndryshoje, por per te siguruar nje funksionim sa me normal te Drejtorise se te Ardhurave, ne zbatim te ligjit Nr. 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", ku administrimi i takses vendore mbi Biznesin e vogel i kalon njesive te qeverisjes vendore, mendojme krijimin e nje nenkategorie subjektesh te biznesit te vogel, te cilet tregetojne ne tregun e lire te qytetit ne prona publike, per efekt te klasifikimit te tarifes se pastrimit.

Persa i perket kesaj kategorie subjektesh te biznesit te vogel te cilet ushtrojne aktivitet ne tregun e lire te qytetit ne prona publike, mendojme qe tarifa e pastrimit te jete 1500 lek ne vit.

Gjithashtu propozojme miratimin e 3(tre) tarifave te reja si me poshte:

1. Tarife per perdorim te tregut te lire te qytetit
    a) Per tregetim mallra industriale 30 lek/m2/dite.
    b) Per tregetim mallra ushqimore, fruta-perime, veze 40 lek/m2/dite
    c) Per tregetim mish, peshk, bulmet 50lek/m2/dite

Dixhitalizuar nga Qendra Ç;IP www.infocip.org

2. Tarife per ekspozim malli jashte dyqanit 30 lek/m2/ dite
3. Tarife dhenie leje
    a) kantina
    - zona A 60lek/m2/dite
    - zona B 40lek/m2/ dite
    b) kende lojnash 40lek/m2/dite.

Bazuar ne dispozitat e sipercituara, specifikojme se ato subjekte qe do ti neneshtrohen pagimit te tarifave te mesiperme nuk do te jene objekt i takses per zenie hapesire publike.

Taksa per zenien e hapesires publike per subjektet e tjera do te jete ne nivelin e percaktuar ne ligjin Nr.9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", aneksi 6.

Theksojme se persa i perket nivelit te takses vendore mbi biznesin e vogel mbetet niveli i percaktuar ne aneksin Nr 5 ligjit nr.9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore".

**Drejtoria Juridike**

**Liljana Beta**

**Drejtoria e te Ardhurave**

**Soniel Prifti**

**KRYETAR**

**NIKO PELESHI**

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org